

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit (Programi: Master i mësimdhënies në matematikë)
Titulli i lëndës:	Mësimdhënia dhe të nxënit e matematikës II
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I (Sem I)
Numri i orëve në javë:	2+2 (4 orë)
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	E martë, 14.00 – 15.30
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr. Eda Vula Ass. Blerina Tafolli
Detajet kontaktuese:	eda.vula@uni-pr.edu ;
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Ky kurs është vazhdim i kursit Mësimdhënia dhe të nxënit e matematikës I. Kursi është planifikuar për të zhvilluar shkathtësitë e nevojshme të studentëve për mësimdhënie të matematikës në arsimin e mesëm të ultë dhe të lartë të Kosovës.</p> <p>Gjatë kursit studentët do të aftësohen që të përshtatin njohuritë specifike të lëndës së matematikës me praktikën bashkëkohore. Ata do të zhvillojnë planifikime dhe aktivitete që bazohen në kompetencat matematike dhe mësimdhënien e bazuar në hulumtime me fokus në çështjet që lidhen me zhvillimin e të kuptuarit të koncepteve për numrat real, konceptet nga gjeometria, algjebra dhe statistika. Hulumtimet në fushën e mësimdhënies së matematikës, analiza e zgjidhjes së problemeve, argumentimet dhe modelimet matematikore do të jenë bazë për reflektimin për aspektet teorike dhe ato praktike të mësimdhënies.</p>
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është zhvillimi i shkathtësive të nevojshme të studentëve për zbatimin e njohurive konceptuale dhe atyre procedurale në mësimdhënie të matematikës në shkollën e mesme të ultë dhe atë të lartë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> shqyrtojnë parimet e Kurrikulës bërthamë për arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë të Kosovës. analizojnë strategjitë kognitive dhe metakognitive për të nxënit dhe mësimdhënies së matematikës; shfrytëzojnë RME për organizimin e aktiviteteve mësimore planifikojnë mësimet të bazuara në mësimdhënien e bazuar në hulumtime vlerësojnë rëndësinë e përfshirjes së strategjive të vlerësimit formativ në orët e matematikës

	<ul style="list-style-type: none"> • analizojnë edukimin për STEM dhe të integrojnë njohuritë matematikore me ato nga fushat tjera kurrikulare për modelimet dhe zgjidhjet e problemeve nga jeta e përditshme • dizajnojnë aktivitete efektive për nxënësit e klasave 6-9 dhe 10-12 dhe të reflektojnë për kompetencat dhe rezultatet e pritshme të nxënësve 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	4	4
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Koha e studimit vetanake të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	14	28
Përgaditja përfundimtare për provim	4	4	16
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	2	2
Projektet,prezentimet ,etj	3	1	3
Totali			139
139: 25 ≈ 6 ECTS.			
Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Ligjerata interaktive, puna në grupe, punë individuale dhe punë në çifte.</i>		
Metodat e vlerësimit:			
Vlerësimi i performancës dhe kriteret e vlerësimit: 1. Parimet dhe qëllimi Kurrikulës së matematikës(10 %)			

Studentët do të analizojnë Kurrikulën Bërthamë për fushën e matematikës dhe do të reflektojnë me shkrim për parimet, qëllimet dhe për ngjashmëritë e dallimet me kurrikulat e vendeve tjera.

2. Matematika, unë dhe filozofia ime (shkrim i lirë 10%)

Secili student duhet të shkruajë 3-5 faqe ku diskutohet historia dhe marrëdhënia e tyre personale me matematikën nga shkolla fillore e deri në universitet e ndjekur nga filozofia e tyre e mësimdhënies së matematikës.

3. Planifikim i njësisë mësimore (10%)

4. Projekti hulumtues (Planifikimet e mësimëve të bazuara në hulumtime) (30%)

Studentët do të punojnë në grupe për të prezantuar planifikimet dhe realizimet e projekteve që në fokus kanë zbatimin e matematikës dhe integrimin e saj me fushat tjera për zgjidhjen e problemeve.

4. Provimi përfundimtar 40 %

Provimi përfundimtar përban pyetje dhe detyra nga temat e diskutura gjatë semestrit dhe leximi i materialeve të sugjeruara gjatë semestrit.

Nota përfundimtare:

Pikët (%)	Nota
92-100	10
81- 91	9
70 -80	8
60-69	7
50-59	6

N e

Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> Groth, E. Randall (2013). Teaching Mathematics in Grades 6-12. Developing Research-Based Instructional Practices. Sage Publicatio, Inc. Haggarty, L. (2002). Teaching mathematics in secondary schools. Routledge Falmer Van de Walle, J. (2007, 2010, 2013). Elementary and middle school mathematics: Teaching developmentally. Boston, MA: Allyn and Bacon/Longman, Inc.
-------------------------	---

Literatura shtesë:	<p>KKK, KB 2 dhe KB 3, MASHT; Planet dhe programet mësimore http://masht.rks-qov.net/arsimi-parauniversitar</p> <p>Shënim: Gjatë kursit studentët do të lexojnë edhe artikuj të sygjeruar shkencor dhe profesional nga fusha e edukimit matematikor.</p>
---------------------------	--

Plani i dizajnuar i mësimi:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Paraqitja e kursit. Qëllimet dhe detyrat
Java e dytë:	Kurrikula dhe programet për fushën/lëndën e matematikës (Det.1)

Java e tretë:	Strategjitë e mësimdhënies dhe të nxënit e matematikës. Strategjitë kognitive dhe metakognitive (Det 2)
Java e katërt:	Problemet kontekstuale dhe edukimi realist matematik
Java e pestë:	Vlerësimi në matematikë (Vlerësimi formativ dhe përmbledhës)
Java e gjashtë:	Planifikimi për mësimdhënie (Përfshirja e strategjive të vlerësimit në planet mësimore) (Det 3)
Java e shtatë:	Të menduarit algjebrik. Modelet, funksionet dhe përgjithësimet
Java e tetë:	Zhvillimi i të menduarit gjeometrik dhe nivelet e Van Heile-s
Java e nëntë:	Zhvillimi i të menduarit të nxënësve për statistikën dhe probabilitetin
Java e dhjetë:	Mësimdhënia dhe të nxënit e matematikës bazuar në hulumtime (det 3)
Java e njëmbëdhjetë:	Mësimdhënia e bazuar në projekte
Java e dymbëdhjetë:	Edukimi për STEM – roli i matematikës në zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme (Det 4)
Java e trembëdhjetë:	Prezantimi i projekteve hulumtuese -diskutim
Java e katërbëdhjetë:	Prezantimi i projekteve hulumtuese - diskutim
Java e pesëmbëdhjetë:	Provimi përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Çdo student duhet të:

- Vijoje me rregull ligjëratat dhe ushtrimet
- Lexojë literaturën e kërkuar dhe artikujt e sugjeruar, të marrë pjesë në diskutimet në klasë dhe të gjitha aktivitetet
- Përgatitë dhe dorëzon të gjitha detyrat në kohën e duhur. Çdo vonese do të ndëshkohet me pikë të humbura.
- Përdorë stilin APA në të gjitha detyrat e shkruara
- Kopjimet gjatë provimeve dhe kryerjes së detyrave ndëshkohen sipas procedurave të miratuara në Fakultet
- Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë dhe ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye.
- Studentët kanë të drejtë të hyjnë në provimin përfundimtar më së shumti tri herë (Neni 115 i Statutit të UP-së)